



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 31 gusht 2012
Nr. ref.: RK289/12

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

Rastin nr. KI151/11

Parashtruesi

Sahit Emini

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Komunale në Gjilan, C. nr. 494/06, të 11 prillit 2007; Aktgjykimit të Gjykatës së Qarkut në Gjilan, Ac. nr. 219/07, të 11 shtatorit 2009; dhe Aktgjykimit të Gjykatës Supreme, A. nr. 1120/83, të 19 janarit 1984

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Enver Hasani, Kryetar
Kadri Kryeziu, zëvendëskryetar
Robert Carolan, gjyqtar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Ivan Čukalović, gjyqtar, dhe

Parashtruesi i kërkesës

1. Parashtrues i kërkesës është Sahit Emini, nga Gjilani. Atë e përfaqëson avokati Avdullah Ismajli, rr. S. Brestovci nr. 15, Gjilan.

Objekti i çështjes

- Objekti i çështjes së kërkesës ka të bëjë me pronësinë e një ngastre kadastrale në Qeremindane, Gjilan, që del nga ndryshimi i rrjedhës së një lumi në vitin 1962. Gjykata Supreme e Kosovës në fund vendosi kundër parashtruesit në aktgjykimin e vet të 5 shtatorit 2011.
- Parashtruesi pohon që i janë shkelur të drejtat e tij kushtetuese të garantuara me nenin 46 [Mbrotjja e Pronës] të Kushtetutës.

Baza juridike

- Kërkesa është e bazuar në nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit Nr. 03/L-121 për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Ligji), dhe në rregullin 56.2 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatë

- Më 14 nëntor 2011, avokati i dërgoi një shkresë Gjykatës, në emër të parashtruesit, lidhur me një kërkesë të propozuar. Më 14 nëntor 2011, Gjykata kërkoi nga parashtruesi që ta plotësonte formularin e kërkesës.
- Më 23 nëntor 2011, parashtruesi e dorëzoi kërkesën e plotësuar në Gjykatën Kushtetuese.
- Më 17 janar 2012, Kryetari i Gjykatës Kushtetuese e caktoi gjyqtaren Gjyljeta Mushkolaj Gjyqtare raportuese dhe Kolegjin shqyrtues të përbërë nga gjyqtarët Snezhana Botusharova (kryesuese), Ivan Čukalović dhe Iliriana Islami.
- Më 18 qershor 2012, Kolegji shqyrtues e shqyrtoi raportin e përgatitur nga Gjyqtarja raportuese dhe i rekomandoi Gjykatës në përbërje të plotë për papranueshmëri. Gjykata në përbërje të plotë e shqyrtoi kërkesën të njëjtën datë.

Përmbledhje e fakteve të rastit të evidentuara nga dokumentet e dorëzuara nga parashtruesi

- Në vitin 1962, lumi që lidh pronën e parashtruesit dhe të babait të tij në Qeremindane, Gjilan, e ndërroi rrjedhën dhe "mori" pronën e parashtruesit. Parashtruesi pohon që shtrati i vjetër i lumit ishte mbushur dhe shndërruar në pronë të tyre.
- Parashtruesi filloi procedurën në Gjykatën Komunale në Gjilan duke kërkuar që t'i njihet e drejta e pronësisë në bazë të shtimit dhe mbajtjes së patundshmërisë. Komuna e Gjilanit ishte e paditura në këtë procedurë. Një shqyrtim u mbajt më 11 tetor 2005 dhe më 24 janar 2006. Gjykata mori parasysh raportet e ekspertëve të gjeodezisë. U bë edhe vëzhgimi i vendit të ngjarjes. Dëshmitarët u dëgjuan gjatë këtij shqyrtimi.
- Në Aktgjykimin e vet C. nr. 76/04, të 24 janarit 2006, gjykata konkludoi që padia ishte e pabazuar sepse parashtruesi dështoi të ofronte prova përkatëse që e dëshmonin të drejtën e tij për njohje të pronës shoqërore. Gjykata gjeti që Ligji përkatës mbi Marrëdhëniet Themelore Pronësore Juridike nuk lejonte që e drejta e pronësisë të fitohej në pronësinë shoqërore në bazë të parashkrimit fitues.

12. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij vendimi në Gjykatën e Qarkut në Gjilan, e cila, me Aktgjykimin e vet V. nr. 494/06, e anuloi vendimin e Gjykatës Komunale dhe e ktheu rastin për rigjykim. Ai shtoi edhe të paditur të tjerë në procedurë.
13. Në rishqyrtimin e mbajtur më 11 prill 2007, Gjykata Komunale në Gjilan me Aktgjykimin C. nr. 494/06 përsëri e refuzoi ankesën e parashtruesit. Në këtë shqyrtim u dëgjuan prova gjithëpërfshirëse nga dëshmitarët dhe ekspertët e gjeodezisë, të cilët kishin përgatitur raporte të reja.
14. Parashtruesi u ankua në Gjykatën e Qarkut, e cila, me Aktgjykimin Ac. nr. 218/07, të 11 shtatorit 2007, e refuzoi ankesën e parashtruesit.
15. Parashtruesi ushtroi ankesë kundër këtij aktgjykimi në Gjykatën Supreme të Kosovës. Më 5 shtator 2011, Gjykata Supreme nxori Aktgjykimin Rev. nr. 42/2008 me të cilin e refuzoi si të pabazuar ankesën e parashtruesit.

Pretendimet e parashtruesit

16. Parashtruesi pohon, ndër të tjera, që Gjykata Komunale në shqyrtimin e dytë nuk e kishte bërë vëzhgimin e vendit të ngjarjes, që gjykatat nuk kishin dhënë arsye të plota për aktgjykimet e veta dhe që kishte pasur vërtetim të gabuar dhe jo të plotë të gjendjes faktike.

Vlerësimi i pranueshmërisë së kërkesës

17. Për të gjykuar për kërkesën e parashtruesit, Gjykata së pari duhet të shqyrtojë nëse parashtruesi i kërkesës i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të përcaktuara në Kushtetutë, Ligj dhe Rregullore të punës.
18. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113.7 të Kushtetutës, i cili thotë:

"Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike dhe të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj."

19. Gjykata Kushtetuese thekson se nuk është Gjykatë e faktit, Gjykata Kushtetuese dëshiron të theksojë se vërtetimi i drejtë dhe i plotë gjendjes faktike është juridiksion i plotë i gjykatave të rregullta dhe se roli i Gjykatës Kushtetuese është vetëm ta sigurojë pajtueshmërinë me të drejtat e garantuara me Kushtetutë dhe instrumente të tjera ligjore dhe prandaj nuk mund të veprojë si "gjykatë e shkallës së katërt", (shih, *mutatis mutandis*, ndër të tjera, Akdivar kundër Turqisë, 16 shtator 1996, R. J. D, 1996-IV, para. 65; shih, gjithashtu, Aktvendimin për Papranueshmëri në Rastin Nr. KI-86/11 – Parashtrues i kërkesës Milaim Berisha – Kërkesë për vlerësimin e kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Rev. Nr. 20/09, të 1 marsit 2011 – të nxjerrë nga Gjykata më 5 prill 2012).
20. Nga faktet e paraqitura së bashku me kërkesën shihet që parashtruesi i kërkesës i ka shfrytëzuar të gjitha mjetet juridike në dispozicion dhe që gjykatat e rregullta i kanë marrë parasysh të gjitha provat e paraqitura nga parashtruesi dhe i kanë dëgjuar dëshmitarët e propozuar nga të gjitha palët në procedurë. Arsyet ishin dhënë për vendimet e marra. Në të vërtetë, Gjykata Komunale në aktgjykimin e vet të 11 prillit 2007 i dha arsyet e veta për mospranimin e provave të një dëshmitari të thirrur në emër të parashtruesit

21. Në këtë drejtim, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pohimin e tij për të sqaruar si dhe pse është bërë shkelja, dhe nuk ka ofruar prova për të dëshmuar se është shkelur e drejta e garantuar me Kushtetutë.
22. Përveç kësaj, kërkesa nuk tregon që Gjykatat kanë vepruar në mënyrë arbitrare apo të padrejtë. Nuk është detyrë e Gjykatës Kushtetuese ta zëvendësojë vlerësimin e vet të fakteve me atë të gjykatave të rregullta dhe, si rregull i përgjithshëm, është detyrë e këtyre gjykatave që t'i vlerësojnë provat që i kanë përpara. Detyra e Gjykatës Kushtetuese është të vërtetojë nëse procedurat në gjykatat e rregullta ishin të drejta në tërësi, duke përfshirë edhe mënyrën e marrjes së provave (*shih Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 13071/87, Edwards kundër Mbretërisë së Bashkuar, para. 34, e 10 korrikut 1991*).
23. Fakti që parashtruesi është i pakënaqur me rezultatin e rastit nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentueshme për shkelje të nenit 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] të Kushtetutës (*shih, mutatis mutandis, Aktgjykimin e GJEDNJ-së, Kërkesa Nr. 5503/02, Mezotur-Tiszazugi Tarsulat kundër Hungarisë, Aktgjykimi i 26 korrikut 2005*).
24. Në këto rrethana, parashtruesi nuk e ka mbështetur me prova pretendimin e tij për shkeljen e nenit 46 [Mbrojtja e Pronës], sepse faktet e paraqitura nga ai nuk tregojnë në asnjë mënyrë që gjykatat e rregullta, të të tri shkallëve, ia kanë mohuar të drejtat e garantuara me Kushtetutë.

PËR KËTO ARSYE

Gjykata Kushtetuese, pas këshillimit dhe votimit të mbajtur më 18 qershor 2012, në pajtim me nenin 113.7 të Kushtetutës, nenin 20 të Ligjit, dhe rregullin 56.2 të Rregullores së punës, njëzëri

VENDOSI

- I. TA HEDHË POSHTË kërkesën si të papranueshme;
- II. Ky Vendim do t'u komunikohet palëve dhe do të publikohet në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- III. Ky Vendim hyn në fuqi menjëherë.

Kryesuesja e Kolegjit shqyrtues

Kryetari i Gjykatës Kushtetuese

Snezhana Botusharova

Prof. dr. Enver Hasani